



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:225221
Datë: 22.05.2024
Numri i dokumentit: 05717461

Ac.nr.2904/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Liridon Maloku-Kryetar i kolegjit, Rafet Haxhaj dhe Besnik Feka, antarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit B.Zh, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson J.O avokat, kundër të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës sh.a., me seli në Prishtinë, për kompensimin e shpërblimit jubilar, duke vendosur sipas ankesës së ushtruar nga i autorizuari i paditësit, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, C.nr.3404/19, të datës 30.12.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 20.05.2024, nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET e themeltë ankesa e paditësit B.Zh, PRISHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Civil, C.nr.3404/19, të datës 30.12.2022 dhe HEDHET poshtë padia e paditësit B.Zh.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.3404/19, të datës 30.12.2022, ka vendosur si vijon: I. REFUZOHET E PABAZUAR kërkesëpafia e paditësit B.Zh, me të cilën ka kërkuar që të DETYROHET e paditura Korporata Energjetike e Kosovës sh.a., që paditësit në emër të tri pagave jubilarë t'ia shumën prej 2,440.56 euro, me kamatë prej 8%, nga dita e paraqitjes së kërkesës e deri në pagesën definitive, si dhe t'ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita kur aktgjykimi të merrë formë të prerë, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë. II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës kontestimore.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë paditësi, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj në tërësi si të bazuar ankesën e paditësit, aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të aprovet në tërësi kërkesëpafia e paditësit.

E paditura nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa e paditësit është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi B.Zh, përmes përfaqësuesit të autorizuar, me dt.08.10.2019, në gjykatën e shkallës së parë ka ushtruar padi për kompensimin e shpërblimit jubilar, kundër të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës sh.a., me seli në Prishtinë, me arsyet sikurse në padi.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, e konform nenit 399 të LPK-së, e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit B.Zh, më decidivisht si në përshkrimin më lartë të këtij aktvendimi.

Pas përfundimit të procedurës në gjykatën e shkallës së parë, lënda sipas ankesës është pranuar në Gjykatën e Apelit, mirëpo para se të shqyrtohet ankesa e paditësit, Gjykata e Apelit me datë 07.02.2024, ka pranuar një parashtesë nga paditësi B.Zh, përmes të cilës informohet gjykata e shkallës së dytë se paditësi e tërheqë padinë, për shkak se me të paditurën kanë arritur marrëveshje jashtëgjyqësore.

Si rrjedhojë, meqenëse palët ndërgjyqëse në mes vete kanë arritur marrëveshje jashtëgjyqësore për zgjidhjen e kontestit në mes tyre, Gjykata e Apelit duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, pretendimet ankimore si dhe vetë parashtesën për tërheqje të datës 07.02.2024 (*e pranuar në Gjykatën e Apelit me datë 07.02.2024*), sipas të cilës rezulton se tani paditësi nuk ka më tutje interes juridik për mbrojtje gjyqësore në këtë çështje juridike kontestimore sipas padisë së iniciuar, sepse interesin e tyre ata e kanë realizuar në procedurën jashtëgjyqësore. Andaj, Gjykata e Apelit në mungesë të interesit juridik të paditësit vendosi që ta pranojë ankesën e paditësit, ta prish aktgjykimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë dhe ta hedhë poshtë padinë e paditësit.

Një konkludim të tillë, Gjykata e Apelit e bazon në dispozitën e nenit 2 paragrafi 4 të LPK-së, sipas të cilës përcaktohet se: *“Pala duhet të ketë interes juridik për padinë dhe për veprimet procedurale tjera që mund të kryhen në procedurë”*, si dhe dispozitën e nenit 391 paragrafi 1 pika e) të LPK-së. Meqenëse në rastin konkret, paditësi me të paditurën çështjen në fjalë e kanë zgjidhur me marrëveshje jashtëgjyqësore të tyre, atëherë del se në situatën e krijuar më nuk ekziston interesi juridik i paditësit për vazhdimin e më tutjeshëm të procedurës.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 195 paragrafi 1, pika b) lidhur me nenin 391 par.1 pika e) të LPK-së, Gjykata e Apelit vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil

Ac.nr.2904/23, me datë 20.05.2024

Kryetar i Kolegjit-Gjyqtari
Liridon Maloku